

MARTESA E DYTE

Kjo Sherbese perdoret kur qe te dy, dhénteri dhe nusja, martohen per here te dyte ose te trete. Kur nje prej ketyre martohet per here te pare, ahere perdoret Sherbese e zakonte e sipërme. Ne kohet e vjetra, nuk u viheshin kurore atyre, qe martóheshin per here te dyte, po aý zakón u-pre, dhe taní u vihen kurore edhe atyre, qe martohen per here te trete. Sidó qofte, atá, qe martohen per here te dyte, nuk kungojne per dy vjet, edhe atá, qe martohen per here te trete, jane te ndaluar prej Kungates te paken per pese vjet.

DHJAKU: Bekó, o Ate.

PRIFTI: I bekuar eshte Perendia yne, gjithënjé, taní e perhere dhe ne jetet e jéteve.

KORI: Amín.

KENDONJESI: Shenjt Perendí, Shenjt i fuqishim, Shenjt i pavdekur, meshirona (3 here).

Lavdí Atit e Birit edhe Shpirtit Shenjt, taní e perhere dhe ne jetet e jéteve. Amín.

Triní e tereshenjte, meshirona; o Zot, hiresoji mekatat tona; o Kryezót, fal-i paudhesite tona; o i Shenjte, veshtroji, dhe sheroji semundjet tona per emrin tent. Meshiró, o Zot (3 here).

Ati yne, qe je ne qell, u-shenjterofte emri yt; arthte Mbreteria jote; u-befte deshira jote si ne qell edhe mi dhé; buken tone te perdíqime épnaje neve sot; edhe fálnaji fajet, sikunder edhe né ua

falim fajtóreve tane; edhe mos na shtjer ne ngasje, po shpetona nga i ligu.

PRIFTI: Se jotja eshte Mbreteria dhe fuqia dhe lavdia, e Atit e Birit edhe Shpirtit Shenjt, taní e perhere dhe ne jetet e jéteve.

KORI: Amín.

DHJAKU: Me paqe le ti lútemi Zotit.

KORI: Meshiró, o Zot.

DHJAKU: Per paqen qe lártazi dhe per shpetimin e shpírteve tona, le ti lútemi Zotit.

KORI: Meshiró, o Zot.

DHJAKU: Per paqen e tere botes, per mirevajtjen e Kísheve te shenjta te Perendise dhe per bashkimin e te gjithave, le ti lútemi Zotit.

KORI: Meshiró, o Zot.

DHJAKU: Per keté Kishe te shenjte dhe per atá, qe hyjne ketú me bese, devotese dhe frike Perendie, le ti lútemi Zotit.

KORI: Meshiró, o Zot.

DHJAKU: Per kryepeshkopin tone (aksh), per prifterinc dhe dhjakerín' e nderuar me Krishtin, per tere klerin dhe pópullin, le ti lútemi Zotit.

KORI: Meshiró, o Zot.

DHJAKU: Per sherbetoret e Perendise (aksh), qe lidhen me njerjatin ne shoqerí martese, dhe per shpetimin e tyre, le ti lútemi Zotit.

KORI: Meshiró, o Zot.

DHJAKU: Qe te bashkejetojne me drejtesí

dhe dashurí, le ti lútemi Zotit.

KORI: Meshiró, o Zot.

DHJAKU: Perkraha, shpetona, meshirona dhe rúajna, o Perendí, me hirin tent.

KORI: Meshiró, o Zot.

DHJAKU: Tereshenjten, te pacinúaren, te permibekúaren, te lavderúaren, Kryezonjen tone, Hyjlíndesen dhe gjithenjé Virgjreshen Marí dyke kujtuar me gjithë Shenjtoret, veten tone dhe njerjatrín dhe tere jeten tone Krishtit Perendí le tja pranojme.

KORI: Ty, o Zot.

PRIFTI: Se ty te ka hie çdo lavdí, nder e adhurím, Atit e Birit edhe Shpirtit Shenjt, taní e perhere dhe ne jetet e jéteve.

KORI: Amín.

Pastáj Prifti thote me ze te larte Uraten e Vleses:

DHJAKU: Le ti lútemi Zotit.

PRIFTI: O Perendí, qe bekove Isaakun dhe Rebeken, ti bekoji edhe sherbetoret e tu (*aksh*), qe po vlohen me unaza pas porrosise sate. Se ti je Perendí meshireplót e njeridashes, dhe ty te dergojme lavdí, Atit e Birit edhe Shpirtit Shenjt, taní e perhere dhe ne jetet e jéteve.

KORI: Amín.

PRIFTI: Paqe te gjítheve.

DHJAKU: Kreret tona Zotit le tja unjim. teve. Amín.

PRIFTI: Se ty te ka hie çdo lavdí, nder e adhurím, Atit e Birit edhe Shpirtit Shenjt, taní e perhere dhe ne jetet e jéteve.

KORI: Amín.

Pastáj Prifti merr unazen e arte, i ben Kryq mi koke dhénterit, edhe thote tri here:

PRIFTI: Vlohet sherbetori i Perendise (*aksh*) me sherbetoren e Perendise (*aksh*), me emrin e Atit e Birit edhe Shpirtit Shenjt. Amín.

Gjithashtú Prifti merr unazen e argjente, i ben Kryq mi koke nuses, edhe thote tri here:

PRIFTI: Vlohet sherbetorja e Perendise (*aksh*) me sherbetorin e Perendise (*aksh*), me emrin e Atit e Birit edhe Shpirtit Shenjt. Amín.

Pastáj Prifti ua ve unazat ne gishterinjte e dores se djathte, dhe kúnteri ua kembén tri here. Dhe menjehere nis Sherbesa e Kurorezimit, edhe Prifti thote Uraten e Marteses se Dyte:

DHJAKU: Le ti lútemi Zotit.

KORI: Meshiró, o Zot.

PRIFTI: O Zoti yne Jesú Krisht, o Fjal' e Perendise, qe u-kryqesove per né, dhe na shpetove nga tiraní' e djallit, kij meshire per sherbetoret e tu (*aksh*), te cilet po lidhen me njerjatrín ne shoqerí martese te dyte, sikunder ke porrositur me anen e Shen Palit, Apostullit tent. Ti, pra, si i mire dhe njeridashes, meshiroji dhe fal-i mekakat e tyre te dáshura dhe te padáshura; lidh-i me dashurí; kurorezoi me lumerí; vleresoi te shikojne

bij e bija reth tryezes tyre; drejtoji pas porrosive te tua, qe te dalin faqebardhe perpara teje, dhe te trashegojne Mbretesine qellore. Se jotja eshte Mbretesia dhe fuqia dhe lavdia, e Atit e Birit edhe Shpirtit Shenjt, taní e perhere dhe ne jetet e jeteve.

KORI: Amín.

Pastáj Prifti i merr kuroret, edhe e kurorézón dhénterin, dyke bere shenjen e Kryqit edhe dyke thene tri here:

PRIFTI: Kurorëzohet sherbetori i Perendise (aksh) me sherbetoren e Perendise (aksh), me emrin e Atit e Birit edhe Shpirtit Shenjt. Amín.

Gjithashtú e kurorézón edhe nusen, dyke bere shenjen e Kryqit edhe dyke thene tri here:

PRIFTI: Kurorëzohet sherbetorja e Perendise (aksh) me sherbetorin e Perendise (aksh), me emrin e Atit e Birit edhe Shpirtit Shenjt. Amín.

Pastáj i bekón, dyke thene:

PRIFTI: Ti o Zot ti o Perendí, i kurorézó me nder e me lavdí.

KORI: Ti o Zot ti o Perendí, i kurorézó me nder e me lavdí (3 here).

Ne keté mes, kúnteri ua kembén kuroret te martúarve tri here.

DHJAKU: Le te veme re.

KENDONJESI: U vure mi krye kurorc prej guresh te çemuar. Te lypne jetet, dhe u ke dhene dite te gjata.

DHJAKU: Urtesí.

KENDONJESI: Kendimi prej Letres se Palit per Efesianet.

DHJAKU: Le te veme re.

KENDONJESI: Vellezer, perhirójeni perhere per te gjitha Perendine dhe Atin me emrin e Zotit tone Jesú Krisht, dyke iu-bindur njerjatrít me frike Perendie. Ju gra, binduni ner burrat tuaj, sikunder i bindeni Zotit, se burri eshte krej i gruas ashtú, sikunder edhe Krishti eshte krej i Kishes, dhe ay eshte shpetimtari i trupit. Pra, sikunder i bindet Kisha Krishtit, ashtú edhe grate duhet tu binden búrrave me çdo sent. Ju burra, dójini grate túaja ashtú, sikunder e ka dashur Krishti Kishen, se e dorézój veten per te miren e saj, qe ta shenjtëronje, ta paqesonje me uje dhe me fjalet, dhe ta lavdëronje si nje dhurate per veten e tij pa njolle, pa zhuber, pa nonjë cen fare, te kulluar dhe te shenjte. Keshtú detyrojne burrat ti duan grat' e tyre, si trupin e vete. Ay, qe dó te shoqen, dó veten e tij, se asnjé njerí nuk e urrén trupin e vete, po e ushqén, dhe e perkujdés, si edhe Krishti Kishen, se jemi mise te trupit te tij, prej mishit te tij dhe prej éshtrave te tij. Perandáj njeriu le atin e nenen, dhe ngjitet pas gruas se tij, dhe behen qe te dy nje trup. Ky Mistér esht i math, edhe keté e thom pas Krishtit edhe pas Kishes. Pra, edhe ju te gjithë, dhe cilidó prej jush le ta doje te shoqen si veten e tij, dhe grúaja le ta nderonje burrin.

KORI: Alilluja, alilluja, alilluja.

DHJAKU: Urtcsí, o te drejte. Le ta degjojme Ungjillin e Shenjte.

PRIFTI: Paqe te gjithëve.

KORI: Dhe me frymen tende.

PRIFTI: Kendimi prej Ungjillit te Shenjte pas Mattheut.

DHJAKU: Le te veme re.

KORI: Lavdí me ty, o Zot, lavdí me ty.

DHJAKU: M' até kohe, u-be nje dasme ne Kaná te Galilese, dhe ishte atjé edhe e-jema e Jesújt. Ishte ftuar ne dashmen edhe Jesúj me Dishépujt' e tij. Dhe kur u-mbarua vera, i thote Jesújt e-jema: "Nuke kanë vere." Jesúj i thote: "Ç' pune kam une me ty, moj grua? S' ka ardhur ora ime édhe." Dhe e-jema u thote sherbetórove: "Beni si tju thote." Dhe ishin atjé gjashte shtemba prej guri, qe ndódheshin per paqesimin e Judenjve, dhe qe nxenin dy a tri masa. Jesúj u thote sherbetórove: "Mbúshini shtembat me uje." Dhe atá i mbushne gjer siper. Pastáj u thote: "Shtini taní, dhe shpjérini kryesófresit." Dhe ia shpune. Dhe kur e ngjerój kryesófresi ujen, qe ishte bere vere, —dhe nuke dinte se qysh, po sherbetoret, qe ia shpune ujen, e dinin,— thirri dhénterin, dhe i thote: "Çdo njerí sjell mé pare veren e mire, dhe kur dehen, ahere sjell te póshteren, po ti e ke mbajtur veren e mire gjer taní." Keté nisje te shénjave beri Jesúj ne Kaná te Galilese, dhe e çfaqí lavdín' e tij, dhe e besuan Dishépujt' e tij.

KORI: Lavdí me ty, o Zot, lavdí me ty.

DHJAKU: Le te thomi te gjithë me tere shpirtin dhe me tere mendjen tone, le te thomi.

KORI: Meshiró, o Zot (3 here).

DHJAKU: O Zot i terefqishim, Perendí i Aterve tane, te lútemi, degjó dhe meshiró.

KORI: Meshiró, o Zot (3 here).

DHJAKU: Meshirona, o Perendí, pas meshires sate se madhe, te lútemi, degjó dhe meshiró.

KORI: Meshiró, o Zot (3 here).

DHJAKU: Te lútemi edhe per meshiren, jeten, paqen, shendetin, shpetimin, veshtrimin edhe ndjesen e mekátave te sherbetórove te Perendise (aksh).

KORI: Meshiró, o Zot.

PRIFTI: Se ti je Perendí meshircplót e njeridashes, dhe ty te dergojme lavdí, Atit e Birit edhe Shpirtit Shenjt, taní e perhere dhe ne jetet e jéteve.

KORI: Amín.

DHJAKU: Perkraha, shpctona, meshirona dhe rúajna, o Perendí, me hirin tent.

KORI: Meshiró, o Zot.

DHJAKU: Diten e tere, te mbare, te shenjte, te paqme dhe te pamekatme, Zotit le ti lypim.

KORI: Falna, o Zot.

DHJAKU: Engjell páqeje, udheheqes besnik, rúajtes te shpírteve dhe te trúpeve tona, Zotit le ti lypim.

KORI: Falna, o Zot.

DHJAKU: Ndjesë dhe falje të fájeve dhe të mekátave tona, Zotit le ti lypim.

KORI: Falna, o Zot.

DHJAKU: Të mirat e të dobishmet për shpirtet tona dhe paqe për botën, Zotit le ti lypim.

KORI: Falna, o Zot.

DHJAKU: Që ta shkojmë kohën e mbetur të jetës sonë me paqe dhe me pendim, Zotit le ti lypim.

KORI: Falna, o Zot.

DHJAKU: Mbarim të krishterë, paqësor dhe faqebardhë të jetës sonë, dhe mprojtje të mirë përpara Gjykatores së trémpshime të Krishtit, le ti lypim.

KORI: Falna, o Zot.

DHJAKU: Bashkimin e fesë dhe shoqërin' e Shpirtit Shenjt dyke lypur, veten tonë dhe njerjatrën dhe tërë jetën tonë Krishtit Perëndí le tja pranojmë.

KORI: Ty, o Zot.

PRIFTI: Dhe vlerësona, o Kryezót, që të kujtojmë të përthërresim ballehapur dhe faqebardhë ty, Perëndinë dhe Atin qëllor, dhe të thomi:

KENDONJESI: Ati ynë, që je në qëll. . . .

PRIFTI: Se jotja është Mbreteria dhe fuqia

dhe lavdia, e Atit e Birit edhe Shpirtit Shenjt, taní e përherë dhe në jetët e jéteve.

KORI: Amín.

PRIFTI: Paqe të gjithëve.

KORI: Amín.

DHJAKU: Krerët tona Zotit le tja unjim.

KORI: Ty, o Zot.

Pastáj Prifti e bekón Verën, dhe thote Uraten e Kupës së Perbashkme:

DHJAKU: Le ti lútemi Zotit.

PRIFTI: O Perëndí, që i bërë të gjitha me fuqinë tendë, bekojë me bekim shpirtëror edhe këtë Kupë të Perbashkme, që u fale sherbetóreve të tu, që u-bashkuan në shoqëri martesë të dytë. Se emri yt është i bekuar, dhe Mbreteria jote e lavdëruar, e Atit e Birit edhe Shpirtit Shenjt, taní e përherë dhe në jetët e jéteve. Amín.

Pastáj Prifti merr Kupën e Perbashkme, dhe ua jep për se trëti më parë Dhëntërit dhe pastáj Nuses. Pastáj Prifti i rotullón të martúarit me kúmtërin, i cili mban kuroret që prápazi, tri herë. Në këtë mes, Kori këndon Troparet pasónjese:

T. T. I: Isaia vallezó, Virgjërësja Zonja Shen Marí, na lindi Jesú Krishtin Emmanuél, njerí edhe Perëndí; dhe emer ka Lindjen që na ndrit. Pra madhështójm' atë, lumërojmë dhe Hyjlíndesen.

T. R: Shpirtet shpëtónani, o Deshmore mprónani, o kurorëprures; përpara Krishtit lútani,

dhe nermjetoni gjithënjë për në.

T. R: Ty të lavdërojmë o Krisht, mburrja e Dishëpujve, gëzimi i Dëshmorëve, që leçitën tok, Trinin' e bashkëqëndshime.

Pastáj Prifti ngre Kuroret, dyke thënë:

PCR DHËNTËRIN: Madhohu, o dhentë, si Abrahami, dhe bekohu si Isaaku, dhe shumë si Jakobi, dyke baritur me paqe, dhe dyke vepëruar me drejtësi porrosit' e Perëndisë.

PCR NUSEN: Dhe ti, o nuse, madhohu si Sara, dhe ngazellohu si Rebeka, dhe shumë si Rakela, dhe gëzohu me burrin, dyke rúajtur porrosit' e ligjës, se ashtú deshi Perëndia.

PRIFTI: Lavdí me ty, o Perëndia yne, lavdí me ty.

KORI: Lavdí Atit e Birit edhe Shpirtit Shenjt, taní e përherë dhe në jetët e jéteve. Amín. Meshiró, o Zot (3 here). Bekó, o Atë.

Pastáj Prifti ben Perleshimin:

PRIFTI: Krishti, Perëndia yne i vertetë, që e bekóje martesën në Kaná të Galileës, me nermjetimet e Shen Marisë; të Shen Apostujve të lavdëruar dhe emërshkelqyer; të Shen Kostandinit edhe Shen Elenës, mbréterve të kurorëzuar; të Shen Prokopit, Dëshmorit të math; të Shenjtit të Kishes (aksh); të Shenjtit të ditës (aksh), të cilin po lusim sot; dhe të gjithë Shenjtëve; na mëshiroftë, dhe na shpëtoftë si i mirë dhe njeridashës.

KORI: Amín.

Pastáj besniket puthin kuroret, edhe i pergezojnë të martuarit. Tete dite pastáj, Prifti thote Uraten e Zgjidhjes së Kuróreve:

PRIFTI: O Zot, o Perëndia yne, që na permetove të bashkojmë shërbetoret e tu (aksh) me lidhjen e martesës së dytë, ti edhe taní, në zgjidhjen e këtyre kuróreve, bekoji të martuarit, dhe rúaje bashkimin e tyre të pandarë, se shërbetoret e tu e mbaruan Shërbesën e Martesës, si në Kaná të Galileës, dhe ty të dërgojnë lavdí, Atit e Birit edhe Shpirtit Shenjt, taní e përherë dhe në jetët e jéteve. Amín.

Pastáj Prifti e perserít Perleshimin e síperme.